





# BULETIN INFORMATIV

## Takimi i tetë i Komitetit Drejtues të Programit SCPA

Aktivitetet e muajit Shkurt 2022



Më datë 24 shkurt 2022 u zhvillua mbledhja e tetë e Këshillit Drejtues të Programit SCPA. Në takim morën pjesë përfaqësues të gjithë institucioneve që janë anëtare të këtij Komiteti. Nga takimi morën pjesë Znj. Petra Burcher, Shefe për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Znj. Linda Gjermani, Menaxherja e Programit, ndërsa nga FCG Sweden drejtori i Programit Z. Pontus Forberg. Në takim u prezantua Raporti i progresit të periudhës gjashtë mujore të programit që përkon me gjashtëmujorin e dytë të fazës së shtesë të programit (2021-2022) dhe Plani i Punës për periudhën në vijim. Znj. Petra Burcher vuri theksin tek rëndësia e kësaj

mbështetjeje dhe bashkëpunimi me PSh-në për të rritur standardet. Ajo gjithashtu konfirmoi se qeveria suedeze do të vazhdojë të mbështesë Policinë e Shtetit në rrugën e saj drejt standardeve evropiane. Z. Rebani Rendit dhe Sigurisë Publike në fjalën e hapjes falënderoi Ambasadën dhe Qeverinë Suedeze për mbështetjen që ofrohet PSh-së për të rritur kapacitetet e saj.

Ai vlerësoi gjithashtu mbështetjen dinamike të ofruar nga Programi që nga fillimi deri më tani dhe bashkëpunimin e ngushtë me strukturat përkatëse për të zbatuar ndryshimet në nivel vendor.

## AKTIVITETET KRYESORE:

- ◆ Takimi i tetë i Komitetit Drejtues të Programit SCPA
- ◆ Vizita monitoruese në DVP – të e Tiranës, Durrësit dhe Fierit
- ◆ Aktivitete ndërgjegjësuese mbi sigurinë në rrugë me nxënësit e shkollës
- ◆ Firmoset Marreveshja e Bashkëpunimit ndërmjet MB dhe MARS për programin “Siguria e te Rinjve”,
- ◆ Aktivitet ndërgjegjësuës me fokus dhunën në familje, Gramsh
- ◆ Takim i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, Prrenjas
- ◆ Seminar me anëtarët e KVSP Pogradec.
- ◆ Aktivitet ndërgjegjësuës me nxënësit e shkollës “Edit Durham”
- ◆ Trainim me të rinjtë mbi sigurinë publike, Shushicë, Elbasan
- ◆ Takim i aktorëve vendorë mbi çështje të Sigurisë pranë njësinë administrative nr. 8

**Vizita monitoruese në DVP – të e Tiranës, Durrësit dhe Fierit**



Gjatë muajit Shkurt 2022, ekipi i ekspertëve të SCPA ka vazhduar takimet monitoruese në Komisarariatet policisë të DVP Tiranë (6 komisarariatet e Tiranës + komisariatin e Kavajës), DVP Durrës (komisariatin e Durrësit, Shijakut dhe Krujës) dhe DVP Fier (Komisariatin e Fierit, Lushnjës, Mallakastrës dhe Divjakës).

Synimi i takimeve ishte të vlerësohej procesi i ndryshimeve të kryer gjatë këtyre muajve të fundit në komisarariatet e varësisë.

Ekipi diskutoi me nivelin drejtues për punën e deritanishme, për rezultatet e pritshme, mënyrën dhe afatet kohore të zbatimit të ndryshimeve si dhe gjendjen aktuale në lidhje me raportin përfundimtar lidhur me zbatimin e ndryshimeve që përcaktohen ne udhëzimin e brendshëm të Drejtorit të DVP.

Fillimisht, në të gjitha takimet u prezantuan disa prej ndryshimeve që tashmë kanë filluar të zbatohen në terren.

Shefat e komisariateve informuan ekspertët e ekipit për hapat e ndërmarrë deri më tani për të zbatuar ndryshimet e parashikuara nga Urdhri i DP dhe Udhëzimi i Brendshëm i DVP-së. Ato shpjeguan në detaje disa nga ndryshimet e zbatuara.

U theksua gjithashtu angazhimi i personelit dhe i resurseve të tjera në kontrollin e territorit për luftën kundër kultivimit të drogës si dhe kufizimet logjistike dhe të burimeve njerëzore që për rrjedhojë do të kenë efekt në ngadalësimin e ritmit të ndryshimeve.

Gjithashtu u ra dakord që të fillojë menjëherë procesi i plotësimit të Raporteve Ditore Cilësore .



**Firmoset Marreveshja e Bashkëpunimit ndërmjet MB dhe MARS per programin “Siguria e te Rinjve”,**

Me datë 18 Shkurt 2022 u firmos Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve “ Per zbatimin e programit siguria e të Rinjve”, është finalizuar dhe firmosur nga te dy ministrat përkatës.


Kjo marrëveshje me numër protokolli 1337 ka për qëllim të sigurojë bashkëpunimin institucional ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Brendshme, me mbështetje nga Policia e Shtetit si dhe Drejtoritë Rajonale Arsimore, në kuadër të zbatimit të programit “Siguria e të rinjve”, për të rritur sigurinë në shkolla dhe në komunitet në përgjithësi.

Ky program zhvillohet në kuadër të zbatimit të filozofisë së Policimit në Komunitet dhe misionit të Policisë së Shtetit “Bashkë për një komunitet më të sigurtë”, në bashkëpunim me palët dhe institucionet e tyre të varësisë që marrin përsipër përgjegjësi të caktuara për të qenë pjesë e këtij programi dhe për të siguruar respektimin e kësaj marrëveshje.

Aty përcaktohen dhe detyrimet përkatëse te ministrive dhe strukturave të varësisë ( neni 6 dhe 7) dhe ne këtë mënyrë mundësohet heqja e disa pengesave burokratike mes institucioneve sidomos ne nivelin lokal.



**Aktivitetet ndërgjegjësuere mbi sigurinë në rrugë me nxënësit e shkollës**



Fituesi i grantit nga Programi Suedez SCPA Gbi – Health & Safety Academy, organizoi në datën 18 shkurt takimin e radhës tashmë me nxënësit e klasave të 12-ta të shkollës “Myslym Keta” në Tiranë, takimin ndërgjegjësuere me tematikë mbi sigurinë rrugore.

Nxënësit e klasave të 12-ta së shpejti do të jenë kandidatë për tu pajisur me lejedrejtimi, prandaj interesi dhe vëmendja për temat e trajtuara ishte i madh.

Në këtë orë tematike u trajtuan tema të tilla si: përdoruesit e rrugës si këmbësorë, çiklistë, moto çiklistë, drejtues mjeti; në lidhje me rrugën dhe elementet e saj; sistemet e sigurisë në mjete (rripi i sigurimit, kaska mbrojtëse); parandalimi i aksidenteve duke rritur vetëdijen qytetare dhe duke respektuar rregullat e qarkullimit rrugor; video me tematike përdorimin e rripit të sigurimit.

Gjithashtu nxënësit testuan përdorimin e rripit të sigurimit nëpërmjet simuloresh “bindës” të vendosur në oborrin e shkollës.

Në këtë takim morën pjesë edhe Drejtori i Policisë Rrugore Z. Altin Qato dhe drejtuesi i Programit Z. Ansi Shundi.

Po në këte kuadër të vijimit të aktiviteteve me shkollat, Gbi – Health & Safety Academy, organizoi në datën 3 shkurt me nxënësit e tre klasave të 12-ta të shkollës “Sadik Stavileci” në Tiranë, takimin ndërgjegjësuere me tematikë mbi sigurinë rrugore.

Gjithashtu nxënësit testuan përdorimin e rripit të sigurimit nëpërmjet simuloresh “bindës” pranë ambienteve të qendrës profesionale GBI.

**Aktivitetet ndërgjegjësuere me fokus dhunën në familje, Gramsh.**



Forumi i Gruas Elbasan, grantmarrëse e raundit 5 të skemës së granteve, në kuadër të projektit “Partneriteti mes Policisë së Shtetit, aktorëve lokal dhe komunitetit në lidhje me DHF dhe DHBGJ”, zhvilloi në Bashkinë Gramsh në datën 2 shkurt forumin publik me djem, gra, vajza, përfaqësues të pushtetit vendor dhe përfaqësues të sektorit të policimit në komunitet, komisariati i policisë Gramsh. Qëllimi i këtij aktiviteti ndërgjegjësimi ishte informimi dhe sensibilizimi i qytetarëve dhe të rinjve mbi fenomenet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, siguria qytetare dhe partneriteti polici – qytetar.



**Takim i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, Prrrenjas**



Në datë 15 Shkurt 2022, në Bashkinë Prrrenjas u realizua takimi i parë i sekretariatit teknik të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike Prrrenjas (KVSP). Mbledhja u lehtësua nga organizata “Në familje, për familjen”, grantmarrëse e raundit të 5të të skemës së granteve, e cila po zbaton në Qarkun e Elbasanit projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm nis me sigurinë publike”. Aktiviteti u realizua me mbështetjen dhe nën kujdesin e Kryetarit të Bashkisë Prrrenjas

z.Nuri Belba dhe Bashkisë Prrrenjas. Të pranishëm në takim ishin specialistë të institucioneve lokale në Bashkinë Prrrenjas, oficerë të policimit në komunitet nga stacioni i policisë Prrrenjas si dhe të shoqërisë civile. Pjesëmarrësit ngritën problematikat që duhet të gjejnë një përgjigje në planin lokal të veprimit 2022-2024

**Seminar me anëtarët e KVSP Pogradec.**



Shoqata “Unë, Gruaja” në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec, më datë 09.02.2022, organizoi një seminar me temë “Roli i Këshillave Vendorë të Sigurisë” (KVSP), me qëllim forcimin e kapaciteteve të anëtarëve të tij në lidhje me çështjet e sigurisë publike. Pjesëmarrës ishin anëtarë të sekretariatit teknik të KVSP Pogradec si edhe përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile.

Gjatë seminarit u prezantua ecuria dhe veprimtaria e KVSP në tremujorin e fundit të vitit të kaluar, detyrat dhe objektivat e punës së sekretariatit teknik të KVSP.

Gjithashtu u sollën gjetje nga vlerësimi i nevojave të komunitetit në Pogradec, që u krye përmes një anketimi të zhvilluar nga shoqata “Unë, Gruaja”.

**Aktivitet ndërgjegjësues me nxënësit e shkollës “Edit Durham”**



Organizata Assist Albania, grantmarrëse e raundit të 5të e skemës së granteve, zhvilloi në datën 2 shkurt një takim me nxënës të shkollës “Edit Durham”. Qëllimi i takimit ishte diskutimi me të rinjtë mbi temën e alkolit, drogës dhe lëndëve narkotike, varësia që krijohet prej tyre, dëmtimet që shkakton përdorimi i tyre në shëndet, dhe mënyrat si të qëndrojmë të shëndetshëm.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit "Komunitet i shëndoshë dhe bashkëveprues për një jetë pa drogë dhe alkool





**Trainim me të rinjtë mbi sigurinë publike, Shushicë, Elbasan**



Në datë 23 Shkurt 2022, në Qendrën Komunitare Multidisiplinare Shushicë, Bashkia Elasan u realizua trajnimi “Të rinjtë për sigurinë publike në nivel vendor”. Pjesmarrës në trajnim ishin të rinj të Këshillit Rinor Njësia Administrative Shushicë, një strukturë komunitare e ngritur nga Bashkia Elbasan. Aktiviteti u lehtësua nga organizata “Në familje, për familjen”,

grantmarrëse e raundit të 5të të skemës së granteve, e cila po zbaton në Qarkun e Elbasanit projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm nis me sigurinë publike”.

Temat e trajtuara trajnimin ishin: kuptimi i konceptit “Siguri publike”, roli i të rinjve dhe koalicioneve vendore në sigurinë publike, si mund të përfshihen të rinjtë në koalicionet vendore për sigurinë publike. Të rinjtë u ftuan

të kenë në vëmendje edhe çështje të lidhura me sigurinë në rrjete sociale. Ato diskutuan dhe sollën raste personale të shokëve të tyre apo të njohurve të përfshirë në sjellje problematike. Gjatë trajnimit u tregua kujdes në nxitjen e të menduarit kritik si dhe për mënyrën e adresimit të problematikës tek specialistët e duhur.

**Takim i aktorëve vendorë mbi çështje të Sigurisë pranë njësinë administrative nr. 8**



Më datë 18 shkurt 2022, Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare zhvilloi takimin e aktorëve vendor mbi çështje të sigurisë pranë njësinë administrative nr. 8. Në këtë takim ishin të pranishëm përfaqësues nga zyra e shërbimit social dhe ekonomik të kësaj njësie, përfaqësues nga policia bashkiake, njësia për mbrojtjen e fëmijëve, specialisti i policimit në komunitet në komisariatit nr. 4,

përfaqësues nga shërbimi parësor shëndetësor, koordinatori i linjës së këshillimit për burra dhe djem dhunues si dhe psikologët nga shkollat publike 9 vjeçare. Fokus i këtij takimi ishte dhuna me bazë gjinore dhe mënyrat e përmirësimit të bashkëpunimit midis institucioneve që ofrojnë shërbime në nivel vendor me qëllim parandalimin e dhunës.

Gjatë këtij takimi u diskutua mbi rastet e dhunës të sjella nga

pjesëmarrësit, si dhe format dhe mënyrat efikase për trajtimin e tyre. Risi e këtij takimi ishte dhe pjesëmarrja e përfaqësuesit nga linja e këshillimit për burra dhe djem dhunues (CLBD) i cili vuri në dukje rëndësinë e shërbimit psikologjik si për viktimën e dhunës ashtu edhe për dhunuesin. Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit “Rritja e efikasitetit të parandalimit të dhunës përmes përfshirjes së